

## VENDIM

Nr.306, datë 25.3.2009

### **PËR SHPALLJEN, KATEGORIZIMIN DHE EMËRTIMIN E PORTIT “PORTO ROMANO”, - “PORT I HAPUR PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 7 të nenit 18 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9298, datë 28.10.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës BOT (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit “Porto-Romano”, në Porto-Romano, Durrës, “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, me specifikat si më poshtë vijon:

- a) Koordinata gjeografike: N 41<sup>0</sup> 22' 36''  
E 19<sup>0</sup> 24' 29'';
- b) Veprimtaria detare: Shkarkim i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- c) Operativiteti: Port i hapur për trafik ndërkombëtar,  
24 orë;
- ç) Shfrytëzimi: Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;
- Faza II: Pronë e shtetit shqiptar dhe e lirë për t'u shfrytëzuar sipas vullnetit të shtetit, pas përfundimit të koncesionit;

- d) Menaxhimi: Faza I: 2 vitet e para të shfrytëzimit të portit nga një kompani e huaj dhe me përvojë në eksperiencën të ngjashme;
- Faza II: Sipas marrëveshjes koncesionare gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;
- Faza III: Shteti shqiptar, përfaqësuar nga organet qendrore përgjegjëse, në fushën e porteve dhe zhvillimit ekonomik.
- dh) Pronësia: Shteti shqiptar, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave.
- Kufizime: Në përdorim të koncesionarit Romano-Port, sh.a., gjatë kohëzgjatjes së koncesionit.
- e) Marrëdhënia me institucionin përgjegjës për transportin: Raportim periodik për volumin e punës së kryer në port.
- ë) Detyrime të tjera: Person kontakti dhe adresë kontakti, në çdo kohë;
- Faqe zyrtare në gjuhën shqipe dhe anglisht, që përmban informacion të plotë mbi rregullat e funksionimit të portit, tarifën e ngarkim-shkarkimit dhe normat ditore të ngarkim-shkarkimit, si dhe informacion mbi situatën e anijeve në port.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrin masa, që në bashkëpunim me koncesionarin, të bëjnë funksionale të gjitha strukturat respektive shtetërore, përfshirë komunikimin nominal të personave, që do t'i ushtrojnë këto funksione në port.

3. Porti bëhet funksional (operativ) 20 ditë kalendarike, pas plotësimit të detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

Sali Berisha